

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit F. P., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes të rëndë në tentativë, nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-ës, sipas propozimit akuzues të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.307/2011 të datës 20.04.2011, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, dhe të akuzuarit, me date 04.12.2015 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. P., nga i ati A. dhe nëna S., me mbiemër të vajzërisë Kokaj, i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin D., Komuna e Suharekës, tani jeton në Prizren, rruga ..., pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i shkurorëzuar, baba i një fëmiut, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 20.06.2008, rreth orës 13,30 minuta, në Prizren, në rrugën ..., pikërisht në objektin ndihmës (depon e konviktit), me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër, në bashkëveprim me të miturin U. K. dhe L. E., tentojnë që të marrin pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që depërtojnë brenda në objekt dhe marrin gjësende të ndryshme kryesisht metalike, mirëpo diktohen nga roja i konviktit dhe ikin nga vendi i ngjarjes,

Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes të rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 52, 73, 74 dhe 75 të KPK-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën te re penale.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore në shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar propozim akuzën PP.nr.307/2011 të datës 20.04.2011, kundër të akuzuarit F. P., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes të rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-ës.

Prokurori i shtetit Musli Gashi në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.307/2011 të datës 20.04.2011, të parashtruar ndaj të pandehurit F. P., për shkak të veprës penale të vjedhjes të rëndë në tentativë, nga neni 253 par.1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-ës, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i mare për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuari F. P., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, unë pendoem thellë për veprën e kryer, por sa më kujtohet mua e tëra ka ndodhur në bashkë veprim me fshatarët e mi U. K. dhe L. E., të cilët kanë qenë pak më të ri se unë, por edhe unë në periudhën kur është kryer vepra penale pra në muajin qershor të vitit 2008, ka qenë fillimi gjegjësisht muajit të parë që kam mbushur moshën madhore. Unë kam qenë në shoqëri me të cekurit, dhe e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, sjelljen time korrekte sot para gjykatës si dhe faktin që unë nuk jam paraqitur në gjykatë më herët për shkak se kam qenë në Z. në punë të përkohshme, dhe me të arritur në Kosovë jam paraqitur në Stacionin policor në Suharekë, pasi që më kanë njoftuar familjaret që jam i kërkuar në bazë të urdhëresat të gjykatës. Pendoem thellë për tërë atë që ka ndodhur, por njëkohësisht i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh moshën time tepër të re në kohën e kryerjes së veprës penale, pendimin tim për kryerjen e veprës, si dhe faktin që tani jam përmirësuar dhe nuk jam më përsëritës dhe nuk kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, andaj konsideroj që të gjitha këto rrethana janë rrethana lehtësuese të cilat i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datë 20.06.2008, rreth orës 13,30 minuta, në Prizren, në rrugën ..., i akuzuari, pikërisht në objektin ndihmës (d. e k.), me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër, në bashkëveprim me të miturin U. K. dhe L. E., tentojnë që të marrin pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që depërtojnë brenda në objekt dhe marrin gjësende të ndryshme kryesisht metalike, mirëpo diktohen nga roja i konviktit dhe ikin nga vendi i ngjarjes,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin kryesor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekzistonte ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë

në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në propozimin akuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban propozim akuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1 të KPK-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit para gjykatës pas kryerjes së veprës penale, moshë e të akuzuarit, është person familjar, baba i një fëmijut, si dhe gjendja e tij ekonomike, komform nenit 74 të KP gjykata mori parasysh rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, bashkëpunimi i përgjithshëm i të akuzuarit me gjykatën, sjelljen e të akuzuarit pas veprës penale të kryer, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënim i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.748/2011 me datë 04.12.2015

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani,

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.